



U R D H Ë R

Nr.208, datë 24. 11. 2017

PËR

NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR HARTIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR DIASPORËN DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

U R D H Ë R O J:

1. Ngritjen e grupit të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe të planit të veprimit, në kuadër të prioritetit qeverisës për krijimin e kushteve për një marrëdhënie të strukturuar me të gjithë shqiptarët në botë, kudo ku ata jetojnë.

2. Grupi i punës të kryesohet nga ministri i Shtetit për Diasporën, i cili në mungesë të tij, kryesimin ia delegon një funksionari të kabinetit. Anëtarët e grupit përfaqësojnë dhe janë përgjegjës për bashkërendimin e punës me ministrinë përkatëse. Grupi i punës të ketë në përbërje:

- Zëvendësministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Zëvendësministrin e Financave dhe Ekonomisë;
- Zëvendësministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Zëvendësministrin e Kulturës;
- Zëvendësministrin e Turizmit dhe Mjedisit;
- Zëvendësministrin e Brendshëm;
- Zëvendësministrin e Drejtësisë;
- Zëvendësministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Zëvendësministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Përfaqësuesin e ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
- Përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

3. Grupi i punës ka për detyrë hartimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën të planit të veprimit. Për këtë qëllim, grupi i punës të organizojë punën në këto drejtime:

- a) Të analizojë kontekstin historik, faktik dhe ligjor për çështjet e diasporës;
- b) Të identifikojë nevojat e diasporës dhe prioritetet qeverisëse;
- c) Të analizojë dhe të përzgjedhë përvojat më të suksesshme të vendeve të tjera në fushën e diasporës;
- ç) Të identifikojë aktet e tjera rregullatore të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare e hulumtimet e bëra nga organizma ndërkombëtarë për çështjet e diasporës;



- d) Të realizojë konsultime paraprake me aktorë të ndryshëm institucionalë dhe shoqërinë civile;
- dh) Të hartojë një plan për konceptimin e një projekti paraprak të prioriteteve kryesore;
- e) Të hartojë planin e veprimit si pjesë përbërëse e strategjisë.

4. Grupi i punës të mbledhet jo më pak se dy herë në muaj dhe sa herë është e nevojshme, me njoftim të kryetarit.

5. Në mbledhjet e grupit të punës mund të ftohen të marrin pjesë edhe ekspertë të cilët mund të vijnë nga struktura të tjera, si organizata jofitimprurëse, organizma ndërkombëtarë, universitetet dhe personalitete të fushës.

6. Grupi i punës të asistohet nga sekretariati teknik, i cili ka për detyrë përgatitjen e dokumentacionit të mbledhjes, komunikimin me institucionet dhe përcjelljen e porosive të grupit të punës, si dhe kryerjen e detyrave të tjera që kërkohen nga grupi i punës në përmbushje të përgjegjësive të veta.

7. Sekretariati teknik të kryesohet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe të ketë në përbërje përfaqësues, specialistë të fushës në nivel ekzekutues nga:

- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme;
- Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatoreve të tjerë, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, në Ministrinë e Kulturës;
- INSTAT-i;
- Agjencia Kombëtare e Diasporës.

8. Ngarkohen titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, që brenda 5 (pesë) ditësh nga hyrja në fuqi e tij, të caktojnë përfaqësuesit e tyre në këtë grup pune.

9. Sekretariati teknik, deri në krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, të kryesohet nga përfaqësuesi i kabinetit të ministrit Shtetit për Diasporën.

10. Ngarkohet ministri i Shtetit për Diasporën për ndjekjen e zbatimit e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA